POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 U vranë sot, viktimat lëviznin me makinë të blinduar! Autorët i pikasën sapo ndërruan automjet

2 E mbuluar nga gjaku dhe e bërë shoshë nga plumbat, Report Tv siguron pamjet e makinës së viktimave në Vlorë

3  Sherri për kalin në 2019, Shpati Lena dhe Hakim Xhezo që u vranë sot, shoku dhe vëllai i Eduart Xhezos! Ekzekutoi 'Arbenin e Çeçesë' se i rrahu rojen

4 Atentat me 2 të vrarë në Vlorë, dalin pamjet nga vendi i ngjarjes! Trupat e viktimave ende në makinë

5 VIDEO e arrestimit/ Sot u ekzekutua në Vlorë, Shpati Lena u prangos 5 muaj më parë por u lirua më pas gjykata

Kronikë

Atentat në autostradën Fier-Vlorë, vriten me breshëri kallashnikovi në makinë Shpati Lena dhe Hakim Xhezo! 3 autorë të dyshuar, shkak dyshohet hakmarrja (VIDEO)

Shpati Lena dhe Hakim Xhezo, vëllai i Eduard Xhezos, aktualisht në burg për vrasjen e Arben Beqirajt, plagosjen e djalit të tij dhe nipit në gusht të vitit 2019, u ekzekutuan sot me breshëri plumbash tek mbikalimi i Panajas në Vlorë. Brenda makinë se djegur të autorëve u gjetën tre armë zjarri dhe ngjarja besohet se ka ndodhur për hasmëri

- U vranë sot, viktimat lëviznin me makinë të blinduar! Autorët i pikasën sapo ndërruan automjet
- E mbuluar nga gjaku dhe e bërë shoshë nga plumbat, Report Tv siguron pamjet e makinës së viktimave në Vlorë
- Sherri për kalin në 2019, Shpati Lena dhe Hakim Xhezo që u vranë sot, shoku dhe vëllai i Eduart Xhezos! Ekzekutoi 'Arbenin e Çeçesë' se i rrahu rojen
- VIDEO e arrestimit/ Sot u ekzekutua në Vlorë, Shpati Lena u prangos 5 muaj më parë por u lirua më pas gjykata
- Kallashnikovi në makinën e shkrumbuar, një prej armëve të krimit të rëndë në Vlorë
- Vrasje në Vlorë, 3 armë automatike gjenden brenda BMW-së së djegur, e shkrumbuar totalisht
- Atentat me 2 të vrarë në Vlorë, dalin pamjet nga vendi i ngjarjes! Trupat e viktimave ende në makinë

Redaksia
18 Gusht, 09:51 | **Përditesimi i fundit: 18 Gusht, 12:40**

VLORË- Nisi si një 'sherr banal' për kalin pothuajse fiks 3 vite më parë që i mori jetën Arben Beqirajt në Vlorë, por saga e hakmarrjes vazhdon! Shpati Lena, 37-vjeç dhe Hakim Xhezo, 34 vjeç, vëllai i Eduard Xhezos aktualisht në burg për vrasjen e Beqirajt, u ekzekutuan sot me breshëri plumbash tek mbikalimi i Panajas në Vlorë.

Viktimat po udhëtonin me një makinë tip 'Mercedez Benz', u qëllua me breshëri plumbash nga pas nga një makinë në lëvizje. Makina tip 'Benz' me të cilin udhëtonin dy viktimat u qëllua me breshëri plumbash me kallashnikov nga një makinë në lëvizje, e cila i qëlloi nga pas, duke i lënë të vdekur në vend.

LEXO EDHE:
Shkurtohet praktika për mësuesit nga 1 vit në 3 muaj, Ministrja e Arsimit: Punësim më i shpejtë!

3 dyshohet se janë autorët që kanë ekzekutuar Shpati Lenën dhe Hakim Xhezon, ndërsa dyshohet se njëri prej tyre i jepte makinës dhe dy të tjerët kanë hapur zjarr ndaj makinës në lëvizje. Pasi u qëlluan me mbi 30 plumba, mjeti i tyre i bërë 'shoshë' nga plumbat dhe u mbuluar nga gjaku, doli rruga duke ecur mbi 200 metra dhe ka përfunduar në një kanal.

Hakim Xhezo është vëllai i Eduard Xhezo, i cili ndodhet në burg për vrasjen e Arben Beqirajt në 2019 . Paraprakisht dyshohet që atentati ndaj të dyve ka lidhje me pikërisht më këtë ngjarje. Viktima Shpati Lena lëvizte nëpër Vlorë me makinë të blinduar, pasi mbase i ruhej një atentati, por jo sot kur e vranë në autostradën Fier-Vlorë!

Pak minuta më vonë policia e Vlorës u njoftua për një makinë tip BMV me targa italiane, në fshatin Frakull të Çerven, nw aksin Levan-Tepelenw, që dyshohet e autorëve. Brenda u gjetën tre kallshnikovë.

Vrasja pas një sherri për kalin që mund t'i këtë marrë jetën Shpati Lenës dhe Hakim Xhezos
Atenati me dy viktimat sot në Vlorë, dyshohet se ka lidhje me një ngjarje kriminale të ndodhur në 4 gusht të vitit 2019 në zonën e plazhit në qytetin bregdetar. Pikërisht ***vrasja e biznesmenit Arben Beqiraj***, nga Eduart Xhezo, pas një sherri për kalin në pronësi të autorit, dyshohet se mund të jetë shkaku i atentati ku u ekzekutua Shpati Lena dhe Hakim Xhezo. Shpati Lena ishte miku i ngushtë, ndërsa Hakim Xhezo është i vëllai i pronarit të kalit, Eduart Xhezos. I vëllai nuk rezulton i përfshirë në ngjarjen e 4 gushtit, por mund të jetë vrarë për hakmarrje ndaj Eduartit, i cili po vuan dënimin me burg. Shpati Lena u arrestua në mars të këtij viti, për 'përkrahje të autorit', ndërsa u la nga gjykata me masën 'detyrim paraqitje'.

Raportuan lajmin për Shqiptarja.com gazetarët e Report Tv Armand Xhelili dhe Arsen Rusta

Në përditësim...

1 / 7

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

[Sh.com] Lajmi i fundit

Shkurtohet praktika për mësuesit nga 1 vit në 3 muaj, Ministrja e Arsimit: Punësim më i shpejtë!

18 Gusht, 12:36

Ora 12:32

E mbuluar nga gjaku dhe e bërë shoshë nga plumbat, Report Tv siguron pamjet e makinës së viktimave në Vlorë

E mbuluar nga gjaku dhe e bërë shoshë nga plumbat. Këto janë pamjet e makinës me të cilën po udhëtonin Shpati Lena dhe Hakim Xhezo, kur u ekzekutuan nën breshërinë e kallashnikovit paraditen e sotme në autostradën Fier-Vlorë.

Ora 12:07

U vranë sot, viktimat lëviznin me makinë të blinduar! Autorët i pikasën sapo ndërruan automjet

Shpati Lena dhe Hakim Xhezo që u vranë sot në atentat në Vlorë lëviznin me makinë të blinduar. Autorët duket se kanë qenë duke i ruajtur dhe sapo kanë vënë re që kishin marrë automjet tjetër, kanë vënë në zbatim planin për atentat.

Ora 11:31

VIDEO e arrestimit/ Sot u ekzekutua në Vlorë, Shpati Lena u prangos 5 muaj më parë por u lirua më pas gjykata

Shpati Lena, i vrarë sot në atentatin në Panaja të Vlorës, u arrestua 23 marsin e kaluar nga policia dhe më pas u lirua nga gjykata. Ai u prangos me 2 të tjerë, ndërsa ishin duke lëvizur me automjet në zonën e Ujit të Ftohtë të dyshuar për ngjarjen e ndodhur në 4 gusht 2019 në Plazhin e Vjetër, ku mbeti i vrarë Arben Beqiraj dhe u plagosur djali i tij dhe një i afërm i tyre. Gjatë operacionit për arrestimin e tyre iu sekuestruan edhe 2 armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak.

Ora 11:29

Sherri për kalin në 2019, Shpati Lena dhe Hakim Xhezo që u vranë sot, shoku dhe vëllai i Eduart Xhezos! Ekzekutoi 'Arbenin e Çeçesë' se i rrahu rojen

Atentati me 2 viktima sot në Vlorë duket se ishte hakmarrje e mirëmenduar dhe e planifikuar prej kohësh pasi lidhet me një tjetër ngjarje kriminale të ndodhur më 4 gusht të vitit 2019. Vrasja e Arben Beqirajt pas një sherri për kalin në pronësi të Eduart Xhezos mund të jetë shkaku i atentatit në Panaja të Vlorës, ku mbetën të vdekur Shpati Lena dhe Hakim Xhezo, të cilët u ekzekutuan me breshëri plumbash. Lena ishte miku ndërsa Hakim Xhezo është i vëllai i pronarit të kalit, Eduartit. I vëllai nuk rezulton i përfshirë në ngjarjen e 4 gushtit por mund të jetë vrarë për hakmarrje ndaj Eduartit, i cili po vuan dënimin me burg.

Si ndodhi ngjarja në 2019

Atentati i sotëm dyshohet të ketë lidhje me vrasjen e ***Arben Beqirajt*** pas një sherri për kalin në pronësi të Eduart Xhezos. Kali i prishi qetësinë disa pushuesve që po bënin plazh në muajin gusht në Vlorë, ndaj Arben Beqiraj me grupin e tij rrahën rojen Gazmend Alushi.

Gazmend Alushi, i cili paguhej 100 mijë lek të vjetra në muaj nga Ermal allias Eduart Xhezo për kujdesin ndaj kalit, është dhunuar me grushte e shkelma në 4 gusht 2019 nga Arben Beqiraj, djali i tij dhe persona të tjerë familjarë që ndodheshin në lokalin e tyre.

Fill pasi ka shpëtuar nga rrahja, Gazmendi ka shkuar në banesën e tij, ku aty i kishte shkuar Ermali duke e pyetur se kush e kishte rrahur, dhe Alushi i ka pohuar se ishte dhunuar nga "Arbeni i Çeçesë". Ermal Xhezo është vënë në lëvizje, ka mobilizuar shokët e tij si Shpati Lena dhe kunatin e tij Ariel Kingji, ku të gjithë janë armatosur me automatikë dhe pistoleta, duke shkuar në ambientet e lokalit të Arben Beqiraj, për tu sqaruar lidhur me rrahjen që ata i kishin bërë kujdestarit të kalit të Ermal Xhezos.

Teksa kanë shkuar për tu sqaruar, janë ulur 3 minuta në një tavolinë dhe më pas kanë nisur përplasjet fizike deri në përdorimin e armëve, duke sjellë vrasjen e Arben Beqirajt dhe plagosjen e djalit të tij dhe Nesim Hodaj. Kjo ngjarje tronditi qytetin e Vlorës në pikun e sezonit turistik, ndërkohë që personat e përfshirë në këtë ngjarje kriminale si Ariel Kingji, Kristi Dolli dhe Shpati Lena u arrestuan nga policia.

Momenti i arrestimit të Shpati Lenës

Shpati Lena, i vrarë sot në atentatin në Panaja të Vlorës, u arrestua më 23 mars të këtij viti pas më shumë se 3 vitesh në kërkim. Ai u prangos me 2 të tjerë, ndërsa ishin duke lëvizur me automjet në zonën e Ujit të Ftohtë të dyshuar për ngjarjen e ndodhur në 4 gusht 2019 në Plazhin e Vjetër, ku mbeti i vrarë Arben Beqiraj dhe u plagosdjali i tij dhe një i afërm i tyre. Gjatë operacionit për arrestimin e tyre iu sekuestruan edhe 2 armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak.

Lirimi i Shpati Lenës

Tre persona u arrestuan për vrasjen e Arben Beqirajt më 23 mars të këtij viti, Gjykata e Vlorës vendosi masën e sigurisë 'arrest me burg', për Ariel Kingjin dhe Kristi Drollin, ndërsa ka vendosur masën "detyrim paraqitje" për shtetasin Shpati Lena. Në kuadër të operacionit "Waves" (dallgët), u bë arrestimi i Ariel Kingjit, 21 vjeç, Shpati Lena 37 vjeç dhe Gazmend Alushi 50 vjeç, të cilët të tre kishin armë me vete.

Ora 11:19

Zbulohet identiteti i viktimës së dytë të atentatit në Vlorë

Report Tv ka zbardhur identitetin e viktimës së dytë në atentatin e sotëm në Vlorë. Hakim Xhezo është viktima tjetër, ndërsa më herët u mësua se viktimë ka mbetur edhe Shpati Lena.

Ora 11:09

Atentati me 2 të vrarë në Vlorë, BMW që u përdor nga autorët ishte vjedhur disa javë më parë në Durrës

Automjeti tip BMW që u përdor për atentatin me 2 viktima në Vlorë ishte vjedhur në Durrës para disa javësh. Makina nuk kishte targa. Menjëherë pasi qëlluan me breshëri armësh drejt makinës me të cilën po lëviznin 2 viktima, njëri prej të cilëve është identifikuar si Shpati Lena, autorët kanë braktisur BMW në Frakull të Fierit.

Ata i kanë vënë flakën makinës brenda së cilës lanë edhe 3 kallashnikov dhe janë larguar me shpejtësi. Kjo është thuajse e njëjta skemë që përdoret në çdo atentat në Shqipëri.

Ora 11:08

Atentati me dy të vrarë në Vlorë, zbulohet identiteti i një prej viktimave

Gazetari i Report Tv Arsen Rusta ka mësuar identitetin e një prej viktimave të atentatit në Vlorë. Njëri prej viktimave është Shpati Lena, ndërsa dyshohet se janë nga Vlorë. Shpati Lena nuk është një emër i panjohur për policinë, kjo pasi ka qenë arrestuar më parë si i përfshirë në vrasjen ku mbeti i vrarë pronari i lokalit në plazhin e Vlorë Arben Beqiraj. Ngjarje e ndodhur në gusht të vitit 2019. Grupi i Shpati Lenës, vrau Arben Beqirajn pas një sherri për kalin e Eduart Xhezos që hyri në plazh.

Ora 10:54

Atentati me 2 të vrarë në Vlorë, policia jep detajet zyrtare! Makina e autorëve pa targa

Policia e Vlorës ka dhënë detajet e para për ngjarjen e rëndë të ndodhur në Vlorë, ku u vranë 2 të rinj.

> *“Sot, rreth orës 09:50, në dalje të fshatit Panaja, në aksin rrugor Fier-Vlorë, në rrethana ende të pa qarta, dyshohet se janë vrarë me armë zjarri, dy shtetas ende të paidentifikuar, të cilët ndodhen brenda një automjeti tip "Benz". Gjatë krehjes së zonës, në fshatin Çerven, në aksin rrugor Levan-Tepelenë, nga shërbimet e Policisë është konstatuar duke u djegur një automjet i braktisur tip "BMË", pa targa, i cili paraprakisht dyshohet se mund të jetë i autorit/ve të ngjarjes. Nga këqyrja paraprake e automjetit dallohen në brendësi të tij, 3 armë zjarri automatike. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë ndodhet në vendin e ngjarjes, ku vijon puna për zbardhjen dhe dokumentin e plotë të rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve, si dhe identifikimin e dy shtetasve të gjendur pa shenja jete. Shërbimet e Policisë së DVP Vlorë, Delta Forcës e FNSH-së, në bashkëpunim me DVP Fier kanë ngritur pika kontrolli dhe po krehin zonën për të bërë të mundur kapjen e autorëve”, thuhet në njoftimin e policisë.*

Ora 10:51

Kallashnikovi në makinën e shkrumbuar, një prej armëve të krimit të rëndë në Vlorë



Në këtë foto të siguruar ekskluzivisht nga gazetari i Report Tv Arsen Rusta duket që në makinën e shkrumbuar totalisht që dyshohet e autorëve të vrasjes së Panaja të Vlorës një kallashnikov edhe ai i djegur. Në makinë janë gjetur 3 armë automatike.

Ora 10:47

Atentati në Vlorë, momenti kur trupat e pajetë nxirren nga makina (VIDEO)

Dy trupat e pajetë të cilët u vranë nga një atentat mafioz në aksin Fier-Vlorë, në afërsi të mbikalimit të Panajasë, janë nxjerrë nga makina, e cila pasi është qëlluar me breshëri plumbash ka përfunduar në një kanal.

Ora 10:44

Vrasje në Vlorë, 3 armë automatike gjenden brenda BMW-së së djegur, e shkrumbuar totalisht

3 armë automatike janë gjetur në automjetin tip BMW i gjetur i djegur totalisht në Frakull të Fierit dhe që dyshohet se është i autorëve të vrasjes së 2 personave në Panaja të Vlorës.

Ora 10:38

Dy të rinj të vrarë në Vlorë, shkak dyshohet përplasja për trafikun e drogës! Makina e tyre u qëllua me mbi 30 plumba

Mbi 30 plumba janë shkrepur në drejtim të makinës ku udhëtonin viktimat të cila mbetën të vdekur pas një atentati mëngjesin e sotëm në Vlorë në aksin Fier-Vlorë.

Gazetari i Report Tv, Arsen Rusta, raporton se shkak dyshohet përplasja e grupeve kriminale për trafikun e drogës. Përplasja për trafikun e drogës i ka marrë jetën 2 të rinjve.

Ora 10:20

Atentat me 2 të vrarë në Vlorë, dalin pamjet nga vendi i ngjarjes! Trupat e viktimave ende në makinë

Report Tv ka siguruar pamjet nga vendi i ngjarjes së atentatit në By-pass-in e Vlorës mëngjesin e sotëm, ku kanë mbetur të vdekur dy persona. Siç shihet nga pamjet makina është bërë shoshë nga plumbat, ndërsa trupat e dy viktimave ndodhen ende në mjet. Pasi mjeti i tyre është qëlluar me breshëri kallashnikovi, teksa po udhëtonin në afërsi të mbikalimit të Panajas, mjeti ka përfunduar në një kanal.

Ora 10:17

2 të vdekur, bilanci i atentatit në Vlorë! 3 dyshohet se ishin autorët

Report Tv mëson se 3 kanë qenë autorët e atentatit në Vlorë para pak minutash. Kjo sipas dëshmitarëve në vendngjarje.

Ndërkohë që janë 2 viktimat e atentatit.

Ora 10:04

Gjendet makina e djegur në Frakull të Fierit, dyshohet se i përket autorëve të atentatit në Vlorë (VIDEO)

Një makinë është gjetur e djegur në Frakull të Fierit. Dyshohet se i përket autorëve, të cilët ekzekutuan 2 persona në Panaja të Vlorës.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: fier-vlore Eduart Xhezo Hakim Xhezo shpati lena vrasje Vlore

Komento

Komente

Armando arixhiu: 18/08/2022 12:15

Te rrojn ca ka u fola borxhit mbani blindin tim mos dilni se camet jan te poshter jo e po jo jeshilet te ruajn trspin bre d vlores hajddni se dukst u presem

Përgjigju

Vonesa: 18/08/2022 12:15

Vlora ne 2022 se kish ber feste me vrasje e nisi keq sezonin vetem plagosje se ne 2021 ishte super ne renditje me 9 ekzekutime emer dhe mbiemer

Përgjigju

Rendi: 18/08/2022 12:12

Ne cfare vendi jetojme.behen kaq vrasje makabre perdite edhe nuk kapet asnjeri.ne kte vend ska as polici as gjykata dhe as shtet.sa fatkeq qe jemi.

Përgjigju

Cami: 18/08/2022 12:07

Po mo po ashtu si thoni ju esht. Te qe per njerzit e benit kishin rrojtur 100 vjet kta

Përgjigju

Supaxhiu shqipfoles i Athines: 18/08/2022 12:03

R ka fajin policia qe nuk asgjeson grupet mafjoze ne Holland, Beligjike, Gjermani, Angli dhe Spanje qe krijojn konflikte andej dhe pastaj vriten ne Shqiperi! Neve paguajm taksa dhe policia fle gjume! Pse nuk shkon te luftoj krimin atje ku e ka zanafillen?!?! Rrace e poshter!

Përgjigju

Ariu: 18/08/2022 12:00

Si i ka liruar nga gjykata këta?! Po prokurori? po Apeli? Po lesh me qime!

Përgjigju

Tutu: 18/08/2022 11:53

Nuk eshte faji as i policise dhe as i shtetit.. ky eshte produktii drejtesise te shitur prej 30 vitesh.. ndaj do vazhdoje vetegjyqesia… edhe kanuni i Lek Dukagjinit ndaj u shkrua dhe zbatua.., eshte DREJTESIA E PLEPAVE qe po e rrenon kete vend…

Përgjigju

Xhikja pa vulë: 18/08/2022 11:39

Këta vetëm me vdekje mund të lajnë mëkatet e tyre,fatkeqsi e dhimbje janë të pafajshmit që rastësia apo nevoja mund t'i çojë në vënd ngjarje,kush ka marrë jetë nuk ka pse ky popull ti paguhej 50€ ditën burgun,është praktikë botërore që krimi dhe mafja asgjëson vetveten...kush del nga rruga e zotit,vdekjen e ka paracaktuar vetë.

Përgjigju

Aqifi: 18/08/2022 11:37

Policia totalisht inekzistente! Krimi ben kerdine, trafikantet shetisin si bosa neper rruge e policia u qendron larg. Pastaj vetem kur heqin qafe nj-tj

Përgjigju

Gjergj: 18/08/2022 11:05

Policia dhe organet e rendit, ato qè i paguajmè me taksat tona pèr parandalimin dhe zbulimin e kontigjentit kriminal, janè kthyer nè zjarrfikès pa zorra uji, qè vijnè nè vèndin e masakrave pèr tè vènè shirita SKENÈ KRIMI MOS KALO. Kam njè propozim sa serioz aq edhe rentabèl pèr arkèn e shtetit tonè. Kèto shiritat,,,jepjani komunales. Ata, e bèjnè mè lirè dhe mè me efikasitet kètè detyrè. Kèta tè ashtuquajturit POLICI E SHTETIT pastaj, mund tè merren me punè tè tjera, "mè tè rèndèsishme", si psh tè ndihmojnè Habilajt tè jenè tè suksesshèm. Njè grusht njerèz ka Shqipèria sot. Nèse policia e shtetit, SHISH, do tè donin tè kontrollonin territorin,,,nuk ka asnjè pelivan shqipfolès qè do mund tè bènte tè fortin. Policia nè Shqipèri ÈSHTÈ NÈ GJUMÈ. Nèse dikush do vèrtetè shtet, duhet ta zgjojè nga gjumi.!!!

Përgjigju

Anisa: 18/08/2022 11:04

SHUM NDENJEN KAN BER PUSHIM 15 DITESHIN E PAR , KAN FILLUAR PUN PRAP , KU JE XHAXHI ENVER SE DUHET DAL NE NJE FAQE MALI E TE ULERASESH CFAR PASIGURIE KEMI NE DHE FEMIJET TAN .

Përgjigju

Kistra: 18/08/2022 11:02

Parandalimi, zero! Zbulueshmeria, pothuaj zero! Na ruajt Zoti!

Përgjigju

Shteti: 18/08/2022 10:48

A tham do bejme shtet, eshte strategji shtetrore kjo, vriten me njeri-tjetrin keta, opa mbaron s Ka me kriminalitet.....ehu eshte shume e rafinuar si teknik, po une jam kurioz Kush nga keto ministret se Jan femra te gjitha ja Ka shti ne mend kete lloj taktike....

Përgjigju

Titi: 18/08/2022 10:22

Ska shans me gjithe keto vrasje ne vend te mos bashkepunon policia. Eshte ne dijeni per gjithe kriminelat ne vend por nuk ben asgje. Kjo e ben bashpunetor

Përgjigju

> **Juristi:** 18/08/2022 11:04
>
> Ne nje shtet ku institucionet ne menyrete hapur shantazhojne denoncuesit, ehte me shume se bashkpunim. Dhe ne kohen e diktatures institucionet kane qene funksionale.

Gjyli: 18/08/2022 10:20

Jemi fiks si palermo ne ate kohe kur vtiteshin neper autostrada.

Përgjigju

Dhendri i Besnik Bekteshit: 18/08/2022 10:03

Droni edukues sa gjoba ka vene sot ?

Përgjigju

> **Agjenti:** 18/08/2022 12:08
>
> Po i nderrojne nje helike se iu thye

> **Leli:** 18/08/2022 11:50
>
> Ku ka polici ne kete vend polici ka hallin te mari leket si ckane bere drejtoret e tjere e shefat e krimeve qe kan qene ne vlore u mari leket vrasesve dhe nuk gjenden se droni eshte per gjoba ky drejtori sukseshem vetem te koruptu ka vene si drejtus vuri Neritan Nallbanin krye ushtarin e kriminelave. Ne vlore difet kush i bene vrasjet i dine te gjithe vetem policia si di gjithe populli vlores i dine te gjitha vrasjet qe jane bere ne kete qytet por nuk duan turp per vloren e turp per gjithe shtetin u marshin me vete qe nga rama saliu iliri nano e te gjithe

> **ard:** 18/08/2022 10:35
>
> uroj qe vrasesit te kene respektuar rregullat e qarkullimit rruges para dhe mbas aksionit... Po ishe ne rregull droni edukues nuk ka se çfare te te beje... poosiii

> **Droni:** 18/08/2022 10:33
>
> Mos u fut ne rotondo pa ndez sinjal se te mbyt policia , ta merr shpirtin

> **Aitipi:** 18/08/2022 10:26
>
> Ja se po karikohet pak

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

Sondazhi i ditës:
Thirrjet për kursimin e energjisë elektrike, mendoni se zbusin pasojat e krizës energjetike?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë

E mbuluar nga gjaku dhe e bërë shoshë nga plumbat, Report Tv siguron pamjet e makinës së viktimave në Vlorë
18 Gusht, 12:32

Politikë



Atentati në Vlorë, Agalliu: Qyteti bregdetar, vend ku krimi i organizuar kryen vrasje në mes të ditës
18 Gusht, 12:22

Opinion

Plator Nesturi: Berisha në kërkim të taborreve të humbura elektorale

Plator Nesturi
18 Gusht, 12:21

Politikë

Berisha takim me fermerët: Hapja e doganave në kuadër të Ballkanit të Hapur do falimentojë fermat tona
18 Gusht, 12:20

Kronikë



U vra 33-vjeçari në mes të bulevardit në Elbasan, mësohen emrat e autorit dhe personave të tjerë të përfshirë
18 Gusht, 12:09

Kronikë

U vranë sot, viktimat lëviznin me makinë të blinduar! Autorët i pikasën sapo ndërruan automjet
18 Gusht, 12:07

Politikë

Atentati me 2 të vrarë në Vlorë, Alibeaj: Ngjarja dëshmon se shteti është dorëzuar përballë krimit
18 Gusht, 12:05

Sport

Performancat mbreslënëse s’kanë të ndalur, Gega kualifikohet në finalen e kampionatit europian
18 Gusht, 12:01

Kronikë

Kush është i arrestuari për vrasjen e 33-vjeçarit në Elbasan (EMRI)
18 Gusht, 11:51

Kosova & Rajoni

Nis takimi Kurti - Vuçiç në Bruksel, Borrell: Tensionet në veri dëshmojnë nevojën për normalizimim të plotë
18 Gusht, 11:42

Kronikë

VIDEO e arrestimit/ Sot u ekzekutua në Vlorë, Shpati Lena u prangos 5 muaj më parë por u lirua më pas gjykata
18 Gusht, 11:31

Kronikë



Sherri për kalin në 2019, Shpati Lena dhe Hakim Xhezo që u vranë sot, shoku dhe vëllai i Eduart Xhezos! Ekzekutoi 'Arbenin e Çeçesë' se i rrahu rojen
18 Gusht, 11:29

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje